



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0860

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) " FutureBITS " SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komuna e Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit ;"20 Furnizimi me pajisje te Teknologjise Informative" me numër të prokurimit; 616-24-5525-1-2-1, me 07/11/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE " FutureBITS " SH.P.K. me nr. 2024/0860 , e datës 16/09/2024, kurse Vendimi i AK- Komuna e Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "20 Furnizimi me pajisje te Teknologjise Informative" me numër të prokurimit; 616-24-5525-1-2-1, anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Lejohet kthimi i tarifës për ankesë, në vlerën e deponuar për paraqitjen e ankesës, Operatorit ekonomik " FutureBITS " SH.P.K., sipas nenit 31.4. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 31.05.2024, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Ndërsa me datën 23.08.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "Jolix" Sh.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim me vlerë të parashikuar të kontratës 45,000.00 €.

Me 28.08.2024, OE "Futurebits" Sh.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 04.09.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 16.09.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Futurebits" Sh.P.K., me numër protokolli 2024/0860 lidhur me aktivitetin e prokurimit 20 Furnizimi me pajisje te teknologjisë informative me numër të prokurimit 616-24-5525-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraparak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Futurebits" Sh.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (1) : "Në përputhje me Nenin 4.1.26 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), si operator ekonomik dhe ofertues me interes legjitim, duke qenë se kemi paraqitur ofertën më të ulët dhe të plotë për këtë aktivitet, kundërshtojmë vendimin e Autoritetit të datës 23.08.2024. Ne kemi përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe e konsiderojmë të pabazuar përpjekjen për eliminimin tonë nga procesi. - Në lidhje me këtë pike(Transkriptimin), theksojmë se kemi dorëzuar Deklaratën për Specifika Teknike, dhe me këtë dëshmojmë para Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) dhe ekspertëve se: -Në dosjen e tenderit, autoriteti nuk ka kërkuar asnjë link apo katalog, prandaj ne kemi vepruar sipas kërkesave të dokumentacionit të tenderit. Derisa me kërkesën e autoriteti për sqarime, ne si OE kemi dërguar autoritetit sqarimet tona për të shpjeguar në detaje si funksionon dhe si duket sistemi i propozuar, derisa autoriteti ofron përgjigje të papërshtatshme dhe te pabazuar askund, duke cituar: "Dokumentimi i sistemit për transkriptim nuk është i qartë, nuk ka adresë në cloud dhe nuk dihet kush është zhvilluesi i këtij sistemi." Vendimi i autoritetit i datës 23.08.2024, në këtë rast, duket të jetë jo vetëm i pabazuar, por edhe tendencioz, duke synuar eliminimin tonë nga procesi i tenderimit në mënyrë të padrejtë. Përgjigja e dhënë nga autoriteti është jo profesionale dhe nuk mbështetet ne asnjë baze te qëndrueshme. Në kërkesën tonë për rishqyrtim të datës 28.08.2024, kemi kundërshtuar këtë vendim, duke sjellë argumente të qarta që tregojnë përputhshmërinë tonë me kërkesat e dosjes dhe pavlefshmërinë e pretendimeve të autoritetit: Përgjigja nga ne si Operator ishte: Sistemi i ofruar nuk është një platformë publike e aksesueshme nga çdokush. Si operator, për çdo klient dedikojmë një hapësirë të veçantë për qasje në sistemin tonë Cloud. Sa i përket zhvilluesit, kjo nuk ka asnjë relevancë me kërkesat e dosjes së tenderit, ne deklarojmë se kemi të gjitha të drejtat për implementimin e këtij sistemi, pra shihet qarte qe është një vendim tendencioz i pabazuar, jashtë kritereve te dosjes se tenderit dhe pa asnjë kuptim. Gjate implementimi atëherë autoriteti bene kërkesën/zgjedhjen se a dëshiron qe sistemi te jete cloud apo ne server-et e autoritetit, pra kjo është sipas kërkesës ne tender Aneks 1. Autoriteti duhet të marrë parasysh që kemi përmbushur të gjitha kriteret dhe kërkesat teknike të dokumentacionit të tenderit. Për sa i përket vendosjes së sistemit, ne kemi ofertuar të ofrojmë zgjidhjen sipas kërkesës së autoritetit, qoftë në Cloud apo në Serverët e tyre, siç është përcaktuar në dokumentacion e tenderit. Në lidhje me pretendimin e autoritetit për " nuk dihet kush është zhvilluesi ", sqarojmë se oferta është dorëzuar nga ne si operator ekonomik, me identitet të qartë dhe kapacitetin për realizimin e projektit, pretendimi se "nuk dihet kush është zhvilluesi" është i pabazuar dhe nuk qëndron. Zhvillimi dhe implementimi bëhet nga ne si Operator qe kemi ofertuar. Instalimi dhe konfigurimi i sistemit bëhet pas nënshkrimit të kontratës, gjatë fazës së implementimit dhe jo gjatë ofertimit! Tregojmë gatishmëri të plotë për të vendosur sistemin sipas preferencës së autoritetit, në Cloud ose në Serverët e tyre, siç është përcaktuar në dosjen e tenderit nga vete autoriteti, dhe këtë e kemi sqaruar edhe në kërkesën për rishqyrtim të datës 28.08.2024. Megjithatë, autoriteti duket se nuk e ka kuptuar

saktë. Çdo pretendim që del jashtë kërkesave të dokumentacionit është i pabazuar dhe jo i mbështetur në fakte. Konfirmojmë përsëri përputhshmërinë dhe përgjegjësinë tonë për të plotësuar kërkesat e dosjes, përfshirë sistemin e transkriptimit.”

Pretendimi i dytë (II) : “Sistemi për Menaxhimin e Projekteve dhe Detyrave Si palë me interes, ofertues me çmimin më të ulët në këtë aktivitet, duke përbushur plotësisht kërkesat e dosjes së tenderit, kundërshtojmë vendimin e Autoritetit të datës 23.08.2024. Lidhur me citimin e Autoritetit për pikën 2 të vendimit të datës 23.08.2024, ku pretendohet ne nuk plotësojmë: 1.Sistemi për Menaxhimin e Projekteve dhe Detyrave nuk i plotëson kushtet teknike, pikat 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.7, dhe 2.8, Ne kundërshtojmë si të pabazuar vendimin sepse ky pretendim nga autoriteti nuk qëndron për arsyet: Askund në specifikim teknik nuk kërkohet që sistemi të ketë shumë gjuhësinë, dhe ky pretendim nuk qëndron, është tendencioz dhe jashtë kriterëve të dosjes së tenderit, derisa edhe po të kërkohej ne ofrojmë këtë opsion. Nga broshura që kemi ofruar është e pamundur që të shihen të gjitha aspektet funksionale të sistemit, ashtu siç kemi deklaruar në ofertë, ne do të ofrojmë Sistemin që i përshtatet saktësisht kërkesave teknike të kërkuara, derisa Deklarata për Specifikime teknike, siguron autoritetin për përbushjen e kërkesave teknike. Ne e konfirmojmë me përgjegjësi dhe e kemi konfirmuar me deklarate për specifikime teknike, Sistemi ofron krijimin e nën detyrave, e cila nuk ka qenë e mundur të vërehet nga broshura e ofruar. Nga broshura që kemi ofruar është e pamundur që të shihen të gjitha aspektet funksionale të sistemit, ashtu siç kemi deklaruar në ofertë dhe deklarate për specifikim teknik, ne do të ofrojmë Sistemin që i përshtatet kërkesave teknike të saktësuara dhe kërkuara në Ankes 1. Sistemi ofron edhe mënyra tjera të punës përveç formës Kanban, dhe ne deklarojmë sikurse kemi deklaruar me deklaratën për specifikime teknike, Sistemi nga ne është në pajtim të plotë me kërkesat sipas dosjes. Sistemi do të konfigurohet në parametra në momentin e dorëzimit (setup) për Autoritetin. Ne me deklaratë për specifikim teknik kemi garantuar që kjo kërkesë dhe të tjerat përbushen nga Sistemi ofruar. Nga broshura që kemi ofruar është e pamundur që të shihen të gjitha aspektet funksionale të sistemit, ashtu siç kemi deklaruar me deklaratën për specifikacion teknik, ne do të ofrojmë Sistemin që i përshtatet saktësisht kërkesave teknike të kërkuara në Aneks 1. Konstatimi nuk është i vërtetë, sepse ne e kemi në pronësi kodin burimor, derisa për çdo klient ne e përshtasim në bazë të kërkesave dhe pastaj e hostojmë në serverët Cloud në kompaninë OVH në Francë, ose në serverët në Prishtinë, në bashkëpunim me blerësin fundor dhe standardet e sigurisë. Andaj, nëse AK ka pasur ndonjë paqartësi lidhur me këtë është dashur që fillimisht të kërkoj sqarim shtesë në kuptim të Nenit 59, Nenit 71 dhe RrPP Nr. 01/2022 Nenit 38. Bazuar në kërkesat teknike të paraqitura në dosjen e tenderit, ne kemi përpiluar ofertën për pjesën e pajisjeve si dhe sistemit të menaxhimit të detyrave. Autoriteti fillimisht nuk ka kërkuar dëshmi të sistemit, por, pak kërkesës për rishqyrtim ai ka kërkuar broshurë për pajisjet dhe sistemin e menaxhimit të detyrave. Ne kemi ofruar të gjitha sqarimet e nevojshme dhe pamje si dëshmi të sistemit të kërkuar, por Autoriteti Kontraktues nuk i ka marrë parasysh sqarimet tona. Ne jemi të bindur që ne i ofrojmë 100% të gjitha kërkesave të parapara në dosjen e tenderit. Po ashtu, AK ka nxjerrë konstatime të pavërteta dhe vlerësime subjektive rreth ofertës dhe zgjidhjes që ne kemi ofruar, si p.sh.: 2.1 Nuk përkrah shumë gjuhësinë, që është një element i domosdoshëm ligjor. Askund në dosje nuk kërkohet një gjë e tillë, edhe po të kërkohej ne do të ofrojmë këtë funksion, siç e kemi sqaruar edhe në ankesën tonë drejtuar AK. 2.2 Projektet e krijuara nuk kanë mundësi të delegohen te personat tjerë. Ne ankese gjeni te bashkëngjitur një pamje ku shihet që sistemi ofron këtë funksion. Këto janë vetëm disa nga vlerësimet e AK-se, ku pa pasur mundësinë ta përdorin sistemin nxjerrin konstatime të pavërteta. Ne i kemi ofruar edhe sqarime shtesë AK-se, se ky sistem që ne e posedojmë mund të përshtatet (customize) për nevojat e klientit (AK) para dorëzimit sipas nevojave të tyre, dhe pastaj vendoset në dispozicion në infrastrukturën Cloud që ne e posedojmë në Francë apo në Prishtinë, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues..”

Pretendimi i tretë (III) : "Vendimi i datës 04.05.2024, B58 Në E-Prokurim, ne fillimisht ishim shpallur fitues të tenderit. Sipas procedurave të zakonshme dhe përvojës në E-Prokurim, dokumenti i vendimit B58, i datës 04.05.2024, duhet të jete i pranishëm dhe i aksesueshëm në platformë. Ne si operator nuk shohim kete vendim ne sistemin E-Prokurimi."

Pretendimi i katert (IV) : “ Vendimi i datës 04.05.2024, B58 Në E-Prokurim, ne fillimisht ishim shpallur fitues të tenderit. Sipas procedurave të zakonshme dhe përvojës në E-Prokurim, dokumenti i vendimit B58, i datës 04.05.2024, duhet të jete i pranishëm dhe i aksesueshëm në platformë. Ne si operator nuk shohim kete vendim ne sistemin E-Prokurimi. Pretendimi 4: Qasja ne dokumentet e operatorit te rekomanduar Më datën 27.08.2024, pas pranimit të materialeve në CD të ofertës së OE të rekomanduar, konstatoam se dokumentacioni ishte i mangët. Autoriteti na ka ofruar vetëm: Dokumentet e Biznesit, Lidhjen e Ofertës, Vërtetimin e ATK-së, Gjyqësorin e Qendrësë Biznesit, Gjykatën, Deklaratën nën Betim, Sekretin Afarist, Sigurimin. Si OE palë me interes, ne nuk kemi pasur mundësinë të shqyrtojmë plotësisht ofertën e OE të rekomanduar. Autoriteti, sipas LPP-së, duhej të bënte selektimin e dokumenteve që mbrohen nga sekretin afarist dhe të na siguronte qasjen në dokumentet e tjera sipas dispozitave të LPP-së. Në përgaditjen ,parashtrimin e kërkesës për rishqyrtim, nuk kemi qasje në, kontratat dhe referencat, dokumentacionin e stafit, përshkrimin e çmimeve, broshurave dhe dokumenteve te tjera perberese te ofertës. Këto dokumente nuk mund të konsiderohen si sekret afarist, pasi kemi të bëjmë me një aktivitet publik dhe dokumente publike. Katlogu është dhe duhet te jete publik, sikurse neve qe na është kërkuar nga Autoriteti me sqarime shtese, po ashtu edhe referencat dhe kontratat se bashku me çmimet, lidhur me këto AK konform interpretimeve te KRPP dhe LPP do duhej te na ofronte qasjen sipas garantimit te ligjit. Mungesa e qasjes në këto dokumente esenciale minon transparencën e procesit për trajtimin e barabartë dhe është ne kundërshtim me Nenin. 10, 11 te LPP dhe Nenin 7 te RRPP Mos ofrimi i qasjes ne dokumentet nga na e AK është shkelje e rend sipas Nenit 97 te RRPP Nr. 01/2022 pikës c. Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik. Në kërkesat për aktivitetin në fjalë, Autoriteti nuk ka specifikuar kërkesa për gjendjen Ekonomike dhe Financiare të Operatorëve Ekonomikë, pavarësisht kësaj, Autoriteti dokumentet publike nuk duhet ti klasifikoj si sekrete afariste, sepse është kufizuar qasja në informacionin e kërkuar. Mbyllja e dokumenteve publike, në mënyrë të njëanshme dhe pa bazë ligjore, është në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe parimet e transparencës. Të drejtat për të pasur qasje në dokumentet e tenderit nuk varen nga Autoritetit apo Operatorët, por nga ligji i prokurimit publik, të jenë në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara, kjo praktike përfaqëson një shkelje të parimeve të transparencës në prokurimin publik.”

Pretendimi i pestë (V) : “Deklarata për Specifikacion Teknik Autoriteti Kontraktues ka kërkuar në dosjen e tenderit: Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara, të cilat duhet të përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit. Kjo deklaratë për specifikacion teknik nuk është dorëzuar nga OE i rekomanduar. Sipas rregullave të tenderit, Autoriteti Kontraktues duhej të eliminonte ofertën e OE të rekomanduar për mungesën e kësaj deklarate. Ky veprim përbën diskriminim nga ana e autoritetit dhe një mosplotësim të kërkesave të dosjes së tenderit nga OE i rekomanduar. Deklarata për specifikacion teknik është dokumenti kyç që siguron autoritetin kontraktues se operatorët ekonomikë do të përmbushin specifikimet teknike të kërkuara. Kjo deklaratë është esenciale për të garantuar se furnizimet dhe shërbimet do të realizohen në përputhje me kriteret e vendosura në dosjen e tenderit. Mungesa e kësaj deklarate pengon autoritetin të sigurohet për përmbushjen e kërkesave teknike të tenderit. Përderisa ne si Operator nuk e posedojmë deklaratën për specifikacion te operatorit ekonomik te rekomanduar ne dokumentet qe autoriteti na ka ofruar, për ne kjo deklarate nuk është e përmbushur.”

Pretendimi i gjashtë (VI) : “Kontrata Referenca Autoriteti Kontraktues ka kërkuar: 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, ne vlere minimale prej 60,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë). 1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te furnizimeve - shërbimeve. Ne si OE, nuk kemi pranuar dokumentacionin lidhur me kontratat dhe referencat e ofruara nga OE i rekomanduar. Mungesa e këtyre dokumenteve publike dhe pamundësia e shqyrtimit të tyre përbën një mosplotësim të kërkesave të dosjes së tenderit, diskriminim, jo transparence. Sipas kërkesave të autoritetit dhe titullit të prokurimit, si dhe pesha e produkteve të IT-së për këtë aktivitet, është kërkuar që operatorët të ofrojnë

projekte te përfunduar të ngjashme me një vlerë prej 60,000 euro në tre vitet e fundit. Pretendojmë se OE i rekomanduar nuk përmbush kërkesën, andaj, në pamundësi për të shqyrtuar kontratat dhe referencat na është pamundësuar transparenca e procesit. Këto dokumente duke u thirrur ne sekret afarist, nuk duhet të përjashtohen nga shqyrtimi, pasi janë të rëndësishme për vlerësimin e ofertës. Sipas natyrës së këtij aktiviteti të prokurimit dhe kërkesave teknike, kontratat dhe referencat duhet të lidhen me furnizime të teknologjisë informative. Megjithatë, për këtë aktivitet, kontratat dhe referencat që nuk përfshijnë furnizime me harduer nuk janë të mjaftueshme, pasi kemi të bëjmë me "20 Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative". Përderisa ne si Operator nuk e posedojmë kontratat dhe referencat e operatorit ekonomik të rekomanduar në dokumentet që autoriteti na ka ofruar, për ne kjo kërkesë nuk është e përmbushur."

Pretendimi i shtatë (VII) : "Stafi që do të angazhohet në projekt Autoriteti Kontraktues, ka kërkuar: 2. Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt. - Një (1) inxhinier i shkencave kompjuterike (master ose bachelor) me së paku 10 vite përvojë pune - menaxher i projektit. Dëshmia CV, diploma, kontrata për marrëdhënie pune apo me marrëveshje për angazhim në pune. Ne, si Operator Ekonomik, nuk kemi pasur qasje në dokumentacionin për këtë kriter. Mungesa e këtij dokumentacioni për inxhinierin e shkencave kompjuterike (Master ose Bachelor) me 10 vite përvojë si menaxher i projektit, e cila përfshin CV, diplomë, dhe kontrata për marrëdhënie pune, na pamundëson verifikimin e përmbushjes së këtij kriteri. Mungesa e qasjes në këto dokumente minon transparençën e procesit të tenderit për trajtimin e barabartë të gjithë pjesëmarrësve. Përderisa ne si Operator nuk posedojmë Stafin e paraqitur të operatorit ekonomik të rekomanduar në dokumentet që autoriteti na ka ofruar, për ne kjo pike nuk është e përmbushur."

Pretendimi i tetë (VIII) : " Katallogjet e produkteve Ne si operator ekonomik shprehim shqetësim se si autoriteti neve na kërkon me sqarime katallogjet e produkteve derisa nuk na ofron katallogjet e Operatorit që mendohet të shpërblehet me kontrate, andaj me mos praninë e katallogjeve dhe të kualifikuara si sekret afarist për ne si operator ekonomik është diskriminim sepse e kemi të pamundur shqimin e tyre, nuk plotësohet ky kriter në Dosjen e Tenderit dhe kërkojmë që të shohim këto dokumente, të shihet nëse plotësohen kërkesat teknike të produkteve të precizuara nga Autoriteti. Mungesa e kësaj qasjeje mbyll transparençën e të gjithë procesit. Përderisa ne si Operator nuk e posedojmë broshurat e ofruara të operatorit ekonomik të rekomanduar në dokumentet që autoriteti na ka ofruar, për ne kjo pike nuk është e përmbushur."

Pretendimi i nëntë (IX) : " Sistemi i transkriptimit dhe Softueri për menagjimin e detyrave Ne si operator ekonomik shprehim shqetësim se si autoriteti neve na kërkon me sqarime katallogjet derisa nuk na ofron katallogjet e Operatorit që mendohet të shpërblehet me kontrate, andaj me mos praninë e katallogjeve dhe të kualifikuara si sekret afarist për ne si operator ekonomik është diskriminim jo transparenca, sepse e kemi të pamundur shqimin e tyre. Mungesa e kësaj qasjeje minon transparençën e procesit. Përderisa ne si Operator nuk posedojmë broshurat e ofruara të operatorit ekonomik të rekomanduar në dokumentet që autoriteti na ka ofruar, për ne kjo pike nuk është e përmbushur."

Pretendimi i dhjetë (X) : "Përshkrimi i Çmimeve Ne si Operator Ekonomik nuk kemi qasje në dokumentin përshkrues të çmimeve të Operatorit Ekonomik të rekomanduar. Përshkrimi i çmimeve nuk mund të klasifikohet si sekret afarist, pasi ky dokument është i rëndësishëm për të siguruar transparençën dhe për të garantuar që të gjitha çmimet janë të llogaritura në mënyrë të saktë. Mungesa e qasjes në këtë dokument e dëmton transparençën e të gjithë procesit dhe minon trajtimin e barabartë për të operatorët. Përderisa ne si Operator nuk posedojmë paramasën/çmimet e ofruara të operatorit ekonomik të rekomanduar në dokumentet që autoriteti na ka ofruar, për ne kjo pike nuk është e përmbushur."

Duke u referuar kërkesave si më sipër OE "Futurebits" Sh.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me neni 1, 7, 10, 11, 26 pika 4.1, 59, 71 të LPP-së si dhe neni 38 të Rrpp-së. Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që, bazuar në faktet dhe ofertën tonë të plotë, e cila i përgjigjet në mënyrë të saktë kriterëve të dosjes së tenderit dhe është oferta më e lirë në këtë aktivitet, të kualifikojë ankesën tonë si të Bazuar dhe të detyrojë Autoritetin të anulojë njoftimin për dhënien e

kontratës dhe të rikthejë lëndën për rivlerësim.

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim: “Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: “FutureBITS” SH.P.K. Pas hapjes se ofertave për aktivitetin me titull "Furnizimi me pajisje te TI" komisioni i Ri- vlerësimit pranoi dy oferta: OE JOLIX SH.P.K. (44,621.576) dhe OE " FutureBITS " SH.P.K. (43,990.006). Komisioni i Ri-vlerësimit pasi analizoi specifikat e DT konstatoi se OE i përgjegjshëm i cili shpërblehet me kontrate është "JOLIX SH.P.K." me vlerë prej (44,621.576). Kurse OE " FutureBITS " SH.P.K. (43,990.006) konsiderohet si OE i papërgjegjshëm për shkak të mangësive si në vijim: 1. Dokumentimi i sistemit për transkriptim nuk është i qartë, nuk ka adresë në cloud dhe nuk dihet se kush është zhvilluesi i këtij sistemi. 1.Sistemi për Menaxhimin e Projekteve dhe Detyrave nuk i plotëson kushtet teknike si më poshtë: 1.1 Nuk përkrah shumëgjuhësinë, që është një element i domosdoshëm ligjor 2.1. Projektet e krijuara kanë mundësi për detyra në formë të check-listës. por jo që këto detyra të delegohen veçanërisht tek personat përkatës dhe ata të njoftohen edhe me email për këtë delegim, siç është kërkuar në specifikimin teknik "Projektet e krijuara duhet të kenë mundësi të kenë detyra, ku secila detyrë ka datat e planifikuara të fillimit dhe përfundimit. Detyrat mund t'u ndahen dhe delegohen përdoruesve të tjerë. Çdo ndarje apo delegim duhet të shkojë me njoftim përkatës në sistem (preferohet edhe me e-mail)."2.3. Sistemi nuk jep mundësi që çdo detyrë t'i ndahen nën-detyrat. Hierarkia e sistemit të ofertuar përfundon tek check lista. 2.4 Nuk është e qartë kush mund ta bëjë aprovimin e mbylljes së detyrave nga dokumentacioni i dorëzuar. 2.5 Sistemi mundëson vetëm formën e punës Kanban, ndërsa nuk mundëson format tjera të kërkuara si Timeline etj. 2.6 Sistemi nuk është i qartë si e mundëson dhe ruan mos-fshirjen e detyrave. 2.7 Sistemi nuk jep detaje të raporteve dhe filtrave të ofruar.2.8 Sistemi bazuar në hulumtimin në internet është open-source, dhe nuk jep detaje të hapësirës ku këto shënime ruhen apo arkitekturës së implementimit. Sa i përket pretendimit ankimor me nr. 1 - duhet cekur se dokumentimi i sistemit për transkriptim të ofertuar nga parashtruesi nuk ka adresë në cloud, nuk është i qartë dhe nuk dihet se kush është zhvilluesi i sistemit. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka ndarë detajet teknike të sistemit si dhe vet deklarimin për të drejtat për implementimin e këtij sistemi. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi. Sa i përket pretendimit ankimor me nr. 2 - është analizuar me kujdes oferta e parashtruesit dhe pretendimi ankimor në mënyrën sikurse është formuluar. Me këtë rast është gjetur se konstatimet e komisionit vlerësues janë të sakta në tërësi. Për këtë arsye është ri konfirmuar se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme dhe për këtë arsye është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit. Sa i përket pretendimit ankimor me nr. 3 - njoftimi B58 mbi vendimin e AK është publikuar dhe evidentohet në mënyrë të rregullt në platformën e prokurimi. Sa i përket pretendimit ankimor me nr. 4 - të gjitha dokumentet që nuk janë cilësuar si sekret afarist janë ofruar për qasje në përputhje me nenin 10 dhe 11 të LPP. Sa i përket pretendimit ankimor me nr. 5, 6, 7, 8 dhe 10 - tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar të gjitha dëshmitë dokumentare sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe ka përmbushur në tërësi kërkesat e dosjes së tenderit për të cilat pretendon parashtruesi. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka prezantuar asnjë dëshmi apo argument të qëndrueshëm me të cilin do të mund të konfirmohet e kundërta. Parashtruesi vetëm ka thënë se dyshon që janë përmbushur kërkesat përkatëse të DT nga tenderuesi i rekomanduar. Rrjedhimisht AK konfirmon se të gjitha kërkesat e DT janë përmbushur në tërësi nga tenderuesi i rekomanduar i cili ka dorëzuar ofertën e përgjegjshme më të lirë në përputhje me kriteret e dhënies së kontratës. Sa i përket pretendimit ankimor me nr. 9 - ky pretendim është identik me pretendimin nr. 8 prandaj vlen përshtatshmërisht përgjigja për pretendimin nr. 8. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nën paragrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nën paragrafin d) të Rregullores nr. 001 / 2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001 /2022 për Prokurimin Publik. Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.”

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Futurebits” Sh.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0860 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): “Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 1 AK, në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të dërguar OE ankues ka dhënë arsyetimin e eliminimit si vijon: “1. Dokumentimi i sistemit për transkriptim nuk është i qarte, nuk ka adrese ne cloud dhe nuk dihet se kush është zhvilluesi i këtij sistemi. 2. Sistemi për Menaxhimin e Projekteve dhe Detyrave nuk i plotëson kushtet teknike si më poshtë: 2.1. Nuk përkrah shumë gjuhësinë, qe është një element i domosdoshmëri ligjor. 2.1. Projektet e krijuara kane mundësi për detyra ne forme te check-listës, por jo qe këto detyra te delegohen veçanërisht tek personat përkatës dhe ata te njoftohen edhe me email për këtë delegim, siç është kërkuar ne specifikimin teknik. "Projektet e krijuara duhet te kenë mundësi te kenë detyra, ku secila detyre ka datat e planifikuara te fillimit dhe përfundimit. Detyrat mund ti ndahen dhe delegohen përdoruesve te tjerë. çdo ndarje apo delegim duhet te shkoje me njoftim përkatës ne sistem (preferohet edhe me e-mail)." 2.3. Sistemi nuk jep mundësi qe çdo detyre ti ndahen nen-detyrat. Hierarkia e sistemit te ofertuar përfundon tek check lista. 2.4. Nuk është e qarte kush mund ta beje aprovimin e mbylljes se detyrave nga dokumentacioni i dorëzuar. 2.5. Sistemi mundëson vetëm formën e punës Kanban, ndërsa nuk mundëson format tjera te kërkuara si Time line etj. 2.6. Sistemi nuk është i qarte si e mundëson dhe ruan mos-fshirjen e detyrave. 2.7. Sistemi nuk jep detaje te raporteve dhe filtrave te ofruar. 2.8. Sistemi bazuar ne hulumtimin ne internet është open-source, dhe nuk jep detaje te hapësirës ku këto shënime ruhen apo arkitekturës se implementimit.”. AK, në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës lidhur me këtë pikë ka dhënë arsyetimin si vijon: “Sa i përket pretendimit ankimor me nr. 1 - duhet cekur se dokumentimi i sistemit për transkriptim te ofertuar nga parashtruesi nuk ka adrese ne cloud, nuk është i qarte dhe nuk dihet se kush është zhvilluesi i sistemit. Ne anën tjetër parashtruesi nuk ka ndare detajet teknike te sistemit si dhe vet deklarimi për te drejtat për implementimin e këtij sistemi. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar ne tërësi. Sa i përket pretendimit ankimor me nr. 2 - është analizuar me kujdes oferta e parashtruesit dhe pretendimi ankimor ne mënyrën sikurse është formuluar. Me këtë rast është gjetur se konstatimet e komisionit vlerësues janë te sakta ne tërësi. Për këtë arsye është ri konfirmuar se parashtruesi ka dorëzuar oferte te papërgjegjshme dhe për këtë arsye është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit. parashtruesi nuk ka prezantuar asnjë dëshmi apo argument te qëndrueshëm mete cilin do te mund te konfirmohej e kundërta. Parashtruesi vetëm ka thënë se dyshon qe janë përmbushur kërkesat përkatëse te DT nga tenderuesi i rekomanduar. Rrjedhimisht AK konfirmon se te gjitha kërkesat e DT janë përmbushur ne tërësi nga tenderuesi i rekomanduar i cili ka dorëzuar ofertën e përgjegjshme mete lire ne përputhje me kriteret e dhënies se kontratës. Ne këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar oferte te papërgjegjshme për te cilën mete drejte është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, ndërsa te gjitha pretendimet e tij ankimore janë te pabazuara ne tërësi.” AK, në dosjen e tenderit, përkatësisht në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FTD) ka përcaktuar kërkesën: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit”. AK nuk ka kërkuar ndonjë dëshmi tjetër për përmbushjen e specifikimeve teknike të dhëna në aneksin 1 të dosjes së tenderit. OE ankues ka dorëzuar Deklaratën për specifikacione teknike e cila është e nënshkruar dhe vulosur në të cilën theksohet: “Ne si OE deklarojmë se produktet e ofruara janë ne përputhje te plote me Specifikimet Teknike te kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas Aneks 1 te dosjes se tenderit.” Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 1 Sipas sqarimeve si mësipërm, arsyet e eliminimit lidhur me sistemin për transkriptim nuk janë fare të përmendura si specifikime në aneksin 1. Po ashtu disa nga arsyet e eliminimit lidhur me sistemin për menaxhimin e projekteve dhe detyrave të listuara nga AK si 2.1, 2.8 , nuk përmenden fare në aneksin 1. Më tej, AK nuk kishte kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nga OE-të të dorëzojnë katalog/broshurë me anë të cilave

do të mund të bëhej vlerësimi se plotësohen specifikimet për pajisjet, përkatësisht shërbimet që përfshihen në këtë aktivitet. Kërkesa e vetme ishte të dorëzohet deklarata për plotësimin e specifikimeve teknike, e cila ishte dorëzuar nga OE ankues. Andaj, AK ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 59 ku thuhet se AK do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Rrjedhimisht pretendimi ankimor është i bazuar.”

Konstatimi i dytë (II) : “Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 2: AK në këtë aktivitet të prokurimit, pas procesit të vlerësimit me datë 04.05.2024 kishte publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së B5, ku ishte rekomanduar për kontratë OE ankues. Megjithatë pas kërkesës për rishqyrtim të dorëzuar nga OE Jolix, aktivitetin e kishte kthyer në rivlerësim, rrjedhimisht ishte publikuar njoftimi mbi vendimin e AK-së me datë 23.08.2024. Sipas manualit për përdoruesit e Autoriteteve Kontraktuese, në sistem Njoftimi mbi Vendimin e AK (B58) nuk publikohet më si dokument shtesë tek DT, por publikohet nëpërmjet butonit/funksionit “Publikimi i B58”. Praktikisht, sa herë që ndryshon Njoftimi mbi Vendimin e AK (B58), versioni i fundit është publik. Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 2. Sipas sqarimeve të mësipërme, AK ka publikuar me vendimet konform manualit të përdorimit të sistemit, rrjedhimisht vendimi i fundit ka zëvendësuar vendimin paraprak, andaj pretendimi ankimor në këtë pikë nuk është i bazuar.”

Konstatimi i tretë (III) : “Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 3: OE ankues në pretendimin e tij thekson se më datën 27.08.2024 ka pranuar nga AK në CD vetëm disa nga dokumentet sikurse janë: Dokumentet e Biznesit, Lidhjen e Ofertës, Vërtetimin e ATK-së, Gjyqësorin e Qendrës së Biznesit, Gjykatën, Deklaratën nën Betim, Sekretin Afarist dhe Sigurimin. Rrjedhimisht, AK nuk i ka dhënë qasje në dokumentet lidhur me kontratat dhe referencat, dokumentacionin e stafit, përshkrimin e çmimeve, broshurave dhe dokumenteve të tjera përbërëse të ofertës. Eksperti shqyrtues dhe teknik kanë verifikuar se OE i rekomanduar në tenderin e tij ka dorëzuar kërkesën për sekret afarist të nënshkruar dhe vulosur me përmbajtjen si vijon: “Te gjitha dokumentet e kërkuar në këtë Aktivitet të prokurimit të cilat bazohen në kërkesat e parapara me Nenin 68 dhe 69 të L.PP-së konsiderohen KONFIDENCIALE.” Në lidhje me këtë kërkesë është dhënë arsytimi si vijon: “Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues kërkesën tonë për Konfidencialitet të e aprovoi ne tërësi dhe të gjitha dokumentet e dorëzuara në këtë Aktivitet të Prokurimit, sipas kërkesave të Nenit 68 dhe 69 të LPP-se, të i trajtoj me konfidencialitet dhe ne rast të kërkesave për çasje në dosjen e tenderit tonë të mos i ekspozohen (shfaqen) palëve të treta. Mospërmubshia e kësaj kërkesë do të na detyrojë të ndërmarrim hapat e paraparë me Ligjin në fuqi.” Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 3: Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se AK nuk ka dëshmuar (përmes procesverbali apo vendimi) që ka bërë klasifikim të informatave sipas kërkesës së OE të rekomanduar. Gjithashtu, AK është dashur të përgatisë versionin e “pastruar” të çdo dokumenti të klasifikuar me element të sekretit afarist. Në fund, AK është dashur të bëjë analizimin në kuptimin që kontratat dhe referencat e lëshuara nga një autoritet publik të mos i klasifikojë si informatat sekrete afariste. Kjo për faktin se 3 kontratat e prezantuara në listën e kontratave janë kontrata publike të lidhura ndërmjet OE të rekomanduar për kontratë me institucione publike. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.”

Konstatimi i katërt (IV) : “Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 4: OE i rekomanduar në tenderin e tij ka dorëzuar ndër të tjera dëshmitë si vijon: a) Deklaratën për specifikacione teknike e cila është e nënshkruar dhe vulosur në të cilën theksohet: “Ne deklarojmë se mallrat dhe shërbimet e ofruar nga ne përputhet me specifikacionet teknike të përmendura nga Autoriteti Kontraktues në Aneksin 1.” b) Lidhur me kërkesën për listën e kontratave dhe dëshmitë përkatëse, janë dorëzuar dokumentet si: Lista e kontratave, në të cilën evidentohen 3 kontrata. Sipas informatave të prezantuara në këtë listë, 1 kontratë nuk përputhet me kërkesën për faktin se kontrata me numër rendor 2 ka përfunduar me datë 31.10.2020. Ndërsa kontrata me numër rendor 3 ka përfunduar me datë 31.05.2024, për të cilën nuk është prezantuar referencë apo dëshmi tjetër. Në fund, kontrata me numrin rendor 1, në vlerë të deklaruar prej 261,100.00 ka përfunduar me datë 28.10.2023. Lidhur me këtë kontratë është dorëzuar referenca nga AK-Komisioni i Pavarur për Media, e cila mbanë datën 31.01.2024 c) Më tej lidhur me stafin, janë dorëzuar: marrëveshje

për angazhim në punë e nënshkruar në mes të OE Jolix dhe znj.Krenare Rexhepi Drenica, për këtë aktivitet të prokurimit; CV e znj.Krenare Rexhepi Drenica, ku evidentohen përvoja, shkollimi, trajnime/certifikime dhe informata tjera relevante. Ndër të tjera lidhur me përvojën shënohet se e njëjta ka përvojë në kompaninë kompaninë Quantix L.L.C, si Project Manager nga janari i vitit 2020 – vazhdon, Kuest LLC, Project Manager në periudhën maj 2018 - dhjetor 2019, Altima d.o.o, (Software Developer), në periudhën qershor 2012 - maj 2019, Appdec (Junior Software Developer) në periudhën prill 2010 - prill 2011, kompaninë GMDS (Intern-Software developer) në periudhën korrik 2009- gusht 2009. Është dorëzuar po ashtu diploma e lëshuar me datë 11.09.2015 nga Kolegji UBT Prishtinë, për gradën master i shkencave kompjuterike dhe inxhinieri. Në fund janë dorëzuar referencat: referenca e lëshuar nga Quantix e cila mban datën 30.09.2022 në të cilën theksohet se znj.Krenare Rexhepi Drenica është e punësuar nga data 03.01.2020 në pozitën e Menaxheres së Projektit. Referenca e lëshuar nga KUEST L.L.C. me date 29.09.2023 në të cilën theksohet se znj.Krenare Rexhepi Drenica ka qenë e punësuar nga data muaji maj 2018 deri në muajin dhjetor 2019 në pozitën e Menaxheres së Projektit. Referenca e lëshuar nga kompania Altima d.o.o, me datë 02 qershor 2019, në të cilën theksohet se znj.Krenare Rexhepi Drenica ka punuar në pozitën Software Developer, në periudhën qershor 2012 - maj 2019. Referenca e lëshuar nga kompania GMDS në të cilën shënohet se znj.Krenare Rexhepi ka qenë e punësuar si Software developer në periudhën 01 korrik 2009 deri me datë 01 dhjetor 2009. Në fund, referenca e lëshuar nga kompania Appdec në të cilën shënohet se znj.Krenare Rexhepi ka kryer detyrat në pozitën Zhvillues Softuerik në kuadër të programit të praktikës në periudhën 07 prill 2010 deri me 14 prill 2011. d) Lidhur me pikën për katalogë/broshura, eksperti sqaron se në dosje të tenderit nuk është kërkuar dorëzimi i katalogëve/broshurave. Megjithatë OE i rekomanduar ka dorëzuar broshurat si vijon: "1. Broshura Shqip.ai", "2. Bosch Ccsd-Curd", "3.1 Bosch Ccsd_DI", "3.2 Bosch Lbb_4116_10", "4. Tascam Us-1x2hr", "5. Shure Mxa310", "5.1 Shure Aniusb Overview", "5.1 Shure Aniusb-Matrix", "5.2 HPE Aruba Instant On 1930 8G, PoE (124W)", dhe "6 Broshura Ambra". e) Në fund, OE i rekomanduar ka dorëzuar "Përshkrimi i çmimit - Furnizimi me pajisje te teknologjisë informative" në të cilin janë dhënë çmimet për 7 pozicione ku totali i pozicioneve ka vlerën e ofertës prej 44,621.57 euro. Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 4: Sipas sqarimeve të mësipërme, eksperti shqyrtues dhe teknik thekson se OE i rekomanduar ka dorëzuar dëshmitë për të cilat OE ankues pretendon se nuk janë dorëzuar. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar."

Rekomandimi sipas raportit te ekspertit shqyrtues;

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 19/09/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0860/2024, ndërsa me datë 07/10/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0860 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe rekomandojmë që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar me mendimin e ekspertit .

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i

ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritot.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të dhënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE " FutureBITS " SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes Dosjes së tenderit/Njoftimit për kontratë, ku Raporti me rekomandim i ekspertit shqyrtues ka vlerësuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE " FutureBITS " SH.P.K. janë të bazuara.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e 20 Furnizimi me pajisje te teknologjisë informative me numër të prokurimit 616-24-5525-1-2-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Futurebits" Sh.P.K., dhe se Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Futurebits" Sh.P.K., janë të bazuara.

Paneli shqyrtues duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e operatorit ekonomik OE "Futurebits" Sh.P.K. aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "20 Furnizimi me pajisje te Teknologjisë Informative" me numër të prokurimit; 616-24-5525-1-2-1, të Anullohet ,Njoftimi mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues, i datës,22.08.2024 dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës ,ankesën e operatorit e sheh si te bazuar, duke vendosur që aktiviteti i prokurimit me "20 Furnizimi me pajisje te Teknologjisë Informative" me numër të prokurimit; 616-24-5525-1-2-1, të kthehet në Rivlerësim.

Paneli duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje lidhur me pretendimet ankimore, prandaj Paneli shqyrtues mbështet raportin ekspertit shqyrtues me rekomandim që aktiviteti i

prokurimit të kthehet në rivlerësim dhe obligohet AK që në procesin e rivlerësimit të zbatojnë konstatimet e vlerësimit sipas raportit ekspertit shqyrtues të pretendimeve ankimore si të bazuara të OE ankues dhe konform kërkesave Dosjes së tenderit/Njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankesë të OE "Futurebits" Sh.P.K vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " FutureBITS " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: